

SHQIPËRI - FRANCË



EURO2020

AIR ALBANIA STADIUM

E DIEL, 17 NËNTOR, ORA 20:45

macron



WITH
MACRON
YOU ARE A
HERO



macron *store*
| Tirana

Tirana: Ring Center Tirana - Zogu i zi - Tirana, Albania
T: +35 5682006747 - tirana@macronstore.com



TË NDERUAR SPORTDASHËS! TË DASHUR MIQ!

Ju falenderoj të gjithëve që jeni sot të pranishëm në këtë ditë të madhe për futbollin shqiptar. Futbollit shqiptar është në një periudhë rritjeje të vazhdueshme, rritje e cila kulmoi me kualifikimin historik në Euro 2016. Kur nisa rrugëtimin tim në krye të Federatës Shqiptare të Futbollit, ku kishim vetëm një zyrë prej 30 metrash katrorë në shkallët e stadiumit të vjetër dhe nuk kishim një fushë stërvitore për ekipin kombëtar, shumë momente si kualifikimi në European apo ndërtimi i këtij stadium dukeshin për shumë si objektiva të pamundur. Por ne, Federata Shqiptare e Futbollit treguam se duke punuar ditë dhe natë, dhe duke besuar në çdo moment tek ato që bëjmë mund të shkojmë larg. E pamundura për shumëkënd u bë e mundur dhe utopikja një realitet që e prekëm të gjithë.

Sot me përrimin e këtij investimi të jashtëzakonshëm për një vend të vogël si Shqipëria, ne kemi arritur objektivin e dytë madhor pas kualifikimit në Euro 2016. Sigurisht falenderimi për këtë vepër që kemi sot i shkojnë Presidentit të UEFA-s, Aleksandër Ceferin, për mbështetjen e madhe dhe kontributin real financiar në ndërtimin e këtij stadium. Duhet të falenderoj arkitektin Casamonti për projektin e tij shumë të bukur, një stadium modern dhe që ka arritur të ndërthuri në mënyrë perfekte klasiken me modernen, duke ruajtur pjesën historike të këtij stadiumi të projektuar më parë nga Gerardo Bosio.

Duhet të falenderoj Kryeministrin Rama për dashamirësinë e treguar dhe mbështetjen morale që ka dhënë në ndërtimin e këtij ambienti të ëndërruar për shumë kohë nga futbollit shqiptar. Një falenderim dhe një mirënjohje e madhe shkon për kompaninë shqiptare Alb-Star, e cila ka bashkëfinancuar këtë projekt, duke ndërtuar me një cilësi të lartë dhe në kohë rekord një vepër të paparë ndonjëherë në Shqipëri dhe rajonin tonë. Falenderime me zemër për stafin e mrekullueshëm të Federatës Shqiptare që ka punuar ditë dhe natë që sot të kemi të mundur këtë stadium dhe një futboll në rritje të vazhdueshme ditë pas dite dhe vit pas viti.

Të nderuar legjenda të futbollit shqiptar, ju që keni dhënë shpirtin për fanellën e shenjtë kuqezi, ju që keni kaluar një pjesë të rëndësishme të jetës tuaj në këtë stadium duke derdhur lot gëzimi e hidhërimi, duke

i dhuruar emocione të gjithë shqiptarëve, duhet t'ju falenderoj që jeni sot këtu dhe dua t'ju siguroj se ju jeni për Federatën Shqiptare të Futbollit pasuria më e madhe. Për ju dhe për ne ka qënë një ëndërr një stadium i tillë dhe të gjithë bashkë duhet të punojmë që të shkojmë larg. Futbollit shqiptar ka arritur rezultate të kënaqshme në dekadën e fundit, duke qënë në mesin e renditjes së futbollit europian dhe atij botëror, diçka e paarritur më parë.

Për ne ky stadium nuk është stacioni i fundit, por është vijimi i shumë investimeve të mëdha që kemi në proces, siç është stadiumi i ri i Kukësit që po ndërtohet dhe kompleksi i madh i Shtëpisë së Futbollit, të dyja projekte që do të përfundojnë në vitin 2020. Ne kemi shumë e shumë projekte të tjera që do të nisin, me objektivin e vetëm për të zhvilluar gjithmonë e më shumë futbollin në Shqipëri.

Të nderuar miq, ky stadium që ne po inagurojmë sot është ndërtuar i gjithi me financimin e FSHF dhe kompanisë Alb-Star, duke mos marrë asnjë financim nga buxheti i shtetit të Republikës së Shqipërisë. Ne për më tepër i jemi nënshtruar "regjimit fiskal" të Bashkisë së Tiranës duke paguar më shumë se 3 milionë euro, para të cilat shumë mirë mund të ishin investuar për të ndërtuar qindra fusha për fëmijët, të ardhmen e këtij vendi dhe futbollit shqiptar.

Federata Shqiptare e Futbollit ka në objektivin e vet, Futbollit 2030, ndërtimin e 100 fushave të reja stërvitore në të gjithë territorin e Shqipërisë. Një projekt shpëtimtar për të ardhmen e sportit më të dashur për shqiptarët. Duke përfituar nga prania e Kryeministrit shqiptar në këtë ceremoni inagruese, unë do të kërkoja premtimin e zotit Rama për mbështetjen e këtij projekti që duam ta finalizojmë brenda 3 viteve të ardhshme. Gjithashtu do doja premtimin e dëshirës së mirë të Presidentit Ceferin për organizimin e një finalaje Superkupe Europe në këtë impiant që ne kemi ndërtuar.

Ta gëzojmë të gjithë stadiumin e ri kombëtar, ta shijojmë sot, të urojmë një fitore dhe të besojmë se në këtë impiant do të arrijmë kualifikime në European dhe Botëror.

Faleminderit.

Miqësisht,
Armand Duka

NËSE DËSHIRONI TË SIGUROHENI
1 ka vetëm emër...

 **SIGAL** 
UNIQA GROUP AUSTRIA



SIGURONI SHTËPINE

PERMES TELEFONIT APO KOMPJUTERIT

*Përfitoni 20% bonus për blerjen ONLINE
të Sigurimit të Shtëpisë nga:*

- ✓ Zjarri, Rrufeja, Shpërthimi
- ✓ Tërmeti
- ✓ Rrjedhja e tubacioneve
- ✓ Thyerja e xhamave



www.sigal.com.al



SIGAL UNIQA

TIRANA KA WEMBLEY-n E SAJ



Tirana ka Wembley-n e saj. Sonte Franca e Griezmann dhe Mbappe do të pritet nga Shqipëria e Edoardo Reja në modernen "Arena Kombëtare", stadiumi i ri i ndërtuar nga Federata Shqiptare e Futbollit në qendër të Tiranës. Eventi ka një rëndësi të pabesueshme në Shqipëri: kjo e sotmja do të jetë një natë për tu treguar nipërve. Jo vetëm për ceremoninë e inaugurimit të stadiumit apo për kampionët e botës, por mbi të gjitha sepse për të siguruar një nga 18000 biletat e disponueshme (nga kapaciteti 22000) ishte me të vërtetë e vështirë. Faktikisht kanë qenë gati 500 mijë kërkesa për bileta nga gjithë Europa për këtë ndeshje. Shqipëria është një vend me 3 milionë banorë, ndërkohë që 8 milionë shqiptar janë të shpërndarë nëpër botë. Vokacioni i vendlindjes është i fortë, dëshira për të parë rritjen e kombit tënd duke përjetuar eksperiencën e stadiumit të ri është aq e fortë sa nuk ka rëndësi sa i gjatë do të jetë rrugëtimi për të qenë në Tiranë sonte.

Arena Kombëtare buron në zemër të Tiranës. Për të shembur "Qemal Stafa-n" e vjetër, stadiumin historik të Tiranës, dhe për të ndërtuar Arenën e kombëtares, janë dashur 3 vite punime ditë e nate. Sonte bulevardi që te çon nga sheshi "Skenderbej" në sheshin "Nënë Tereza", zemra e kryeqytetit shqiptar, do të jetë i gjithi kuqezi. Dy hapa nga sheshi "Nënë Tereza" ndodhet stadiumi, i projektuar nga arkitekti italian Marco Casamonti, një shkëlqesi në panoramën e arkitektëve botëror. Fati deshi që një arkitekt

fiorentin të projektojë një stadium që lind mbi hirin e një impianti tjetër të realizuar nga një tjetër fiorentin, arkitekti Armando Brasini (një nga më të rëndësishmit e viteve 90') i cili në 1939 projektoi Qemal Stafa-n e vjetër. Një investim prej 75 milion euro i kërkuar me ngulm nga Presidenti Armand Duka, edhe ai arkitekt i rrugëtimit historik të Shqipërisë së De Biasit në Euro 2016. Kurrë më parë Shqipëria se ka pasur kombëtaren e saj në një European, kurrë më parë Shqipëria nuk ka pasur një stadium kaq të madh, kurrë më parë Shqipëria se ka pasur Presidentin e Federatës në Komitetin Ekzekutiv të UEFA-s. Për një vend që po lufton për të hyrë në Bashkimin European, kjo e sotmja është një kartëvizitë e jashtëzakonshme.

Arena Kombëtare është një stadium nga më klasikët, stil anglez. Tribuna me 2 nivele në 3 krahë, publiku afër fushës për të shtyrë skuadrën. Tribuna kryesore ndërkohë ka një karakteristikë unike në llojin e vet: vetem 1400 vende për tu ulur dhe një zonë e madhe e mikpritjes që shtrihet plotësisht në nivelin e dytë të tribunës, që përmban një nga maxi ekran. Një stadium që të kujton "Bombonera-n" e Buenos Aires për organizimin e tribunave. Me dy veçori të tjera shumë moderne. Nga ajri, pamja e stadiumit merr formën stilistike të territorit të Shqipërisë, dhe në vendin e një këndi midis tribunave ngrihet një qiellgërvishës prej

30 katësh që përmban hotele luksoze, qendra konferencash dhe aktivitete tregëtare. Me fjalë të tjera, ajo që e bëri të mundur këtë projekt. Federata Shqiptare e Futbollit ka investuar 10 milione euro, 65 milionë të tjerë për investimin kanë ardhur nga ALB-Star, që do të kurojë aktivitetet tregëtare të këtij impianti, që do të ketë jetë gjithë vitin. Dhe, ekzaktesisht siç ka bërë federata angleze me Wembley-n, stadiumi i kombëtares shqiptare nuk ka pasur nevojë për asnjë kontribut shtetëror.

Vetëm këtë javë është zyrtarizuar marrëveshja me kompaninë ajrore që do ti japë emrin "Air Albania Stadium" stadiumit të ri të kombëtares. Pak rëndësi ka nëse tradicionalistët do të rrudhin fytyrën përballë emrit Air Albania Stadium: as Qeveria dhe as Bashkia Tiranë nuk kanë kontribuar në këtë operacion të zhvilluar vetëm nga FSHF, të cilës i është dashur edhe të përballojë një taksë prej 4 milion eurosh të vendosur për këtë rast nga Bashkia e kryeqytetit Shqiptar.

Dhe kështu, gjithë të rëndësishmit e futbollit sot do të jenë në Tiranë. Pak rëndësi ka që Franca është e kualifikuar dhe që Shqipëria prej tre ndeshjesh tashmë është jashtë. Midis 22000 pjesmarrësve në Arenën Kombëtare do të jenë mbi 2000 të ftuar, aq sa tribuna kryesore është përjashtuar nga shitja e biletave. Aty do të jetë Aleksander Ceferin, Presidenti i UEFA-s dhe një prej dirigjentëve kryesor të FIFA-s, duke qenë se Gianni Infantino ka prenotuar tashmë prezencën e tij për vitin që vjen. Para ndeshjes është parashikuar një ceremoni inagurimi e denjë për një event të madh, siç është për Shqipërinë inagurimi i stadiumit të saj të ri. Ose më saktë, i Wembley-t të Ballkanit.

BOTIM ZYRTAR I
FEDERATES SHQIPTARE
TE FUTBOLLIT



Tel: +355 423 46601
Fax: +355 423 46609
Email: info@fshf.al

EURO 2020

MISION I KËNAQËSISË

Në nëntor të vitit të shkuar Shqipëria ishte në momentin më kritik të dekadës së fundit. Rezultatet nuk po flisnin në favorin tonë. Liga e Kombeve ishte një mundësi e shpërdoruar në mënyrë kaotike. Vetëm 3 pikë në fitoren kundër Izraelit dhe më pas 3 humbje, asnjë gol i shënuar dhe tetë të pësuar. Sidomos disfata e fundit 4-0 me Skocinë në Shkodër dha ndjesinë e një kthimi në kohë. Hera e fundit që ishim mundur me 4 gola diferencë në fushën tonë kish qënë në 1993 kundër Spanjës. Atë natë Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, gjithsesi vendosi ti jepte ish trajnerit Panucci dhe një tjetër shans. Eliminoret do fillonin në mars dhe ndoshta stafi dhe lojtarët deri atëherë do reflektonin dhe diçka do ndryshonte.


...
Humbja 0-2 kundër Turqisë i dha fund një raporti që nisi me dëshirën e mirë por që përfundoi me rezultate shumë larg realitetit e pritshmërive, mungesë qetësie dhe polemika në publik. Edi Reja u shfaq në orbitën kuqezi me pamjen e aktorit të famshëm në mo-

tivin e Hemninguej "Plaku dhe Deti". I urtë, me 40 vite karrierë, por me një sfidë që të ngjasonte me dallgët e oqeanit. Duhej të zbuste një det të tërë me emrin Shqipëri. Në Andorrë ekipin e drejtoi Bulku, i ndihmuar nga Sulejman Mema dhe një fitore 3-0 atje risolli disi optimizmin se ndoshta nuk do kualifikohemi por të paktën do jemi dinjitozë siç kemi bërë gjithnjë. Në një grup me Francën, Turqinë dhe Islandën, kuotat e kualifikimit ishin pothuajse të pamundura. Që të ndodhte duhet të fitonim çfarë na dilte para. Dy humbjet 1-0 në Rejkjavik dhe Stamboll i dhanë pothuajse fund shpresave. Nëse në Island ndoshta nuk u treguam aq agresivë sa duhet, në Turqi



zhvilluam një nga ndeshjet më të mira jashtë fushës sonë. Mungesa e fatit në rastet e krijuara dhe gabimi që mund ti ndodhë kujt do i kordinimit në mbrojtje në minutën e fundit sollën humbjen më të trishtë të këtyre viteve. Ajo natë ishte e denjë për një titull të faqes së parë. Fitore e shëmtuar, humbje e bukur! Fitorja ishte e Turqisë, ndërsa humbja e Shqipërisë.

Ndërkohë fitoret 4-2 me Islandën dhe 4-0 në Moldavi ishin një kënaqësi e madhe, konfirmim i faktit që me Rejen në stol gjërat në këtë skuadër kishin ndryshuar. Në të dyja rastet u vendosën dy rekorde pozitive. Asnjëherë më parë nuk kishim fituar një ndeshje zyrtare duke shënuar 4 gola dhe asnjëherë më parë nuk kishim fituar një ndeshje zyrtare me 4 gola diferencë. Ca më tepër jashtë fushës sonë. Gjatë kësaj periudhe krahas rezultateve super dinjitoze u afruan dhe disa lojtarë të rinj në skuadër duke krijuar idenë e një rinovimi gradual dhe pa kosto të grupit e sidomos titullarëve. Dermaku dhe Ismajli në mbrojtje, Bare



e Gjasula në mesfushë e Manaj në sulm kanë fituar statusin e atyre që e nisin nga minuta e parë. Këta për të përmendur disa emra sepse Reja po tregohet gjithnjë e më inteligjent në grumbullimet e tij. Ofron gjithnjë diçka të re, por nuk ka asnjë derë të mbyllur, përkundrazi gëzon respektin edhe të atyre që i le në shtëpi. Skuadra në drejtimin e tij fitoi pikërisht këtë lloj komunikimi relativ, me baza liberale në disa ditë: të gjithë sëbashku për të përfaqësuar kombin.

Tani kemi arritur në sprintin final të një edicioni që nisi si një det i trazuar me peshkagënët gati për të na përpirë dhe po mbaron me një anije që në drejtimin e njeriut të urtë po del në det për tu qetësuar dhe për të nisur një tjetër udhëtim. Një sukses me Francën mund të na dhurojë vendin e tretë, një pozicion shumë i mirë duke pasur parasysh që këtë renditje kishim dhe në eliminatorët e shkuara të Botërorit. Për Shqipërisë që zakonisht para se të shkonte në Europianin e Francës, ka qënë e fundit ose e parafundit nga pikëpamja e statistikave duhet të qëndrojë si një sukses.

Ndeshja me Francën duhet të jetë një festë. Për herë të parë Shqipëria do të luajë në një stadium të ri, modern, konkurrues me stadiumet më të rëndësishme të Europës. Në rajon në këtë drejtim jemi më para se sa disa vende që futbollin ndoshta e kanë më të zhvilluar se ne, si Kroacia e Serbia. Shqipëria shpreson që stadiumi i

ri ti japë një ogur më shumë, pavarësisht se sigurisht kundërshtarët mund të jenë gjithashtu në nivelin e stadiumit të ri. Tani Shqipëria dhe skuadra Kombëtare duhet të men-

dojnë për Ligën e Kombeve dhe eliminatorët e Botërorit të ardhshëm. Ëndrra është e madhe. Ashtu sikundër shkua një ditë në Europian, mund të shkojmë një ditë dhe në Botëror. Ndërkohë duhet të shijojmë rritjen e skuadrës dhe mrekullinë me emrin "Air Albania Stadium".



KUSH ËSHTË

EDOARDO REJA

Kur Edi Reja u ul për herë të parë në pankinën e Molinelës, një skuadër modeste italiane, 40 vite më parë në 1979 ai as nuk e mendonte që në moshën 74 vjeçare do ulej për herë të parë në pankinën e një skuadre Kombëtare, pikërisht në atë shqiptare që 4 dekada më parë as nuk imagjinohej të kishte në gjirin e saj një trajner të huaj. Asokohe Shqipëria e izoluar kishte marrë vendimin të mos përfaqësohej në futbollin ndërkombëtar.

Kush është njeriu që i dha sërish shpresë kësaj skuadre dhe në kohë rekord largoi shijen e hidhur të Panuccit dhe riktheu optimizmin dhe idenë se të shkuarit në Europian nuk ishte një rastësi por një gjë që herët a vonë mund të ndodhë sërish.

I qetë, i urtë, mbi 1 mijë ndeshje në repertorin e tij, komunikues perfekt, formë fizike e shkëlqyer dhe një inteligjencë e lindur për të mos prodhuar polemika dhe për ti shuar ato pako zjarre që në gjenezë. Konservator në idetë e tij taktike, i fiksuar pas skemës 3-5-2, strikt në kërkesat e disiplinës në fushë, por liberal, i zgjuar dhe nga ata që i bën lojtarët për vete me sjelljen e tij që në gjuhën "popullore" meriton dhe epitelin babaxhan.

Shqipëria ka qënë ndoshta jo një dashuri me shikim të parë, por patjetër një lidhje që konsolidohet dita ditës. Fillimisht ishte skeptik, e ndoqi këtë skuadër në disa ndeshje në 2018-tën, jo në versionin e saj më të mirë, por mendoi se diçka mund të bënte. Me të Shqipëria ka arritur dy rekorde dhe është gati për të regjistruar të tretin. Asnjëherë më parë Shqipëria nuk kishte fituar një ndeshje zyrtare duke shënuar 4 gola, siç ndodhi në Shqipëri Islandë 4-2 dhe asnjëherë më parë Shqipëria nuk kishte fituar një ndeshje zyrtare me 4 gola diferencë, Moldavi-Sqipëri 0-4. Asnjëherë Shqipëria në grupin e saj eliminator nuk ka grumbulluar 15 pikë.

Jo vetëm për rezultatet, por mbi të gjitha për qetësinë dhe harmoninë, rinovimi i kontratës së tij të ngjan gjithnjë e më shumë si formalitet.



PASION, PËRKUSHTIM, KRENARI!



UNIONBANK

Banka që dua

**Mbështesim ëndrrën e
Kombëtares Shqiptare të Futbollit!**



unionbank.al



0800 0800



STAFIK TEKNIK I KOMBËTARES A



SERGIO PORRINI

ZV.TRAJNER



ERVIN BULKU

ZV.TRAJNER



HAMDI SALIHI

ZV.TRAJNER



ILIR BOZHIQI

TRAJNER PORTIERESH



LUIGI FEBBRARI

PERGATITES ATLETIK



LUCA LAURENTI

ZV.PERGATITES ATLETIK



ALARICO ROSSI

VIDEOANALIST



MICHELE GERACE

ASS.VIDEOANALIST



DRITAN BABAMUSTA

MANAXHER I EKIPIT



Full of Life

ZGJIDH FORMATIN TËND TË PREFERUAR!

NGA RISITË E FUNDIT TË UJIT TEPELENE



Uji i Skuadrës
Kombëtare
Shqiptare
të Futbollit



www.ujitepelene.com



Për t'u ndjerë çdo ditë në formë





ARENA

QË MBAN PESHËN E HISTORISË

Stadiumi kombëtar i Tiranës, i konceptuar nga arkitekti italian Gherardo Bozio në vitet 1939-1941, u ndërtuar në formën e një stadiumi olimpiq. Bosio parashikoi për ndërtesën një hyrje monumentale, me shkallë të gjera e relieve skulpturore. Gurin e parë për ndërtimin e stadiumit e ka vendosur në mënyre simbolike Galeazzo Ciano, ministri i jashtëm fashist i Italisë dhe njëkohësisht dhëndëri i Benito Musolinit, në gusht 1939. Punimet për ndërtimin e stadiumit vazhduan katër vjet deri në ndërprerjen e tyre në vitin 1943, kur kapitulloi Italia. Gjatë okupimit nazist stadiumi u përdor nga forcat gjermane si parkim për automjetet e tyre. Punimet për ndërtimin e stadiumit u përfunduan pas Luftës II Botërore. Stadiumi u hap për herë të parë në vitin 1946 me rastin e ndeshjeve për Kupë Ballkanike në futboll. Edhe pse në vitin 1974 u zgjerua me 35,000 vende, në vitin 1994 u kthye në një stadium i gjithi i ulur dhe kështu kapaciteti i tij u reduktua në 16,230 vende.

Sot AIR Albania Stadium, i propozohet qytetit si ndërtesë multifunkionale dhe është konceptuar si një mekanizëm në gjëndje të funksionojë në mënyrë perfekte, duke garantuar në çdo rrethanë ndarjen totale të flukseve të aktiviteteve, në mënyrë që bashkëjetesa dhe simultaniteti i eventeve të jetë gjithmonë e garantuar dhe e sigurtë në çdo rrethanë.



Në brendësi stadiumi i ri i Tiranës prezantohet me një strukturë origjinale që inspirohet nga format e Teatrit Roman, ku shkallët e stadiumit janë 'cavea' e teatrit antik dhe ana e katërt përfaqëson 'frons scenae'. "Skena e teatrit" ka një tribunë të vogël VIP, e limituar me 1400 spektatorë, mbështetur mbi një vetratë të madhe që ka në brendësi Sky-box eksklusivë, të destinuar për një publik të seleksionuar, ku në qendër është Tribuna e autoriteve dhe Tribuna e Mediave sipas vendeve dhe kërkesave të UEFA-s. Mbi Sky-box është një perimetër i mbuluar nga një mur i madh mbi të cilin është vendosur një ekran i madh informativ. I gjithë ky konfigurim, dhe koncepti i teatrit, i jep mundësinë stadiumit të përdoret për koncerte të mëdha. Zgjedhja për të pasur dy unaza në tribuna dhe me akseset të ndara jep mundësinë të përdoret një pjesë e stadiumit kur luajnë skuadra lokale dhe ka një numër më të vogël publiku, në krahasim me rastet kur do të luajnë skuadra kombëtare, ku kapaciteti maksimal prej 22 mijë vendesh do të jetë gjithmonë i ezauruar.




Spitali Amerikan, përqafoje jetën!

Mjekët më të
mirë vendas
dhe të huaj



Ndërhyrje
komplekse



Teknologji
bashkëkohore



Standarte
ndërkombëtare



Spitali Amerikan

042 35 75 35 

www.spitaliamerikan.com   

Profesionalizëm
dhe
përkujdesje





ALBAN HOXHA



ELSEID HYSAJ



KASTRIOT DERMAKU



BERAT DJIMSITI



ETRIT BERISHA



ENEA MIHAJ



HYSEN MEMOLLA



THOMAS STRAKOSHA



FREDERIC VESELI



ARDIAN ISMAJLI



GENTIAN SELMANI



MARASH KUMBULLA



LORENC TRASHI



LEDIAN MEMUSHAJ



EMANUELE NDOJ



BEKIM BALAJ



KLAUS GJASULA



KEIDI BARE



ODISE ROSHI



KRISTI GOSE



FLORIAN KAMBERI



YLBER RAMADANI



REY MANAJ



ERMIR LENJANI



AMIR ABRASHI



MYRTO UZUNI



LINDON SELAHI



TAULANT XHAKA



TAULANT SEFERI



FRANCA

NR	MBIEMËR EMËR	DATËLINDJA	KLUBI KU LUAN
PORTIER			
1	AREOLA Alphonse	27.02.93	REAL MADRID CF
23	MAIGNAN Mike	03.07.95	LOSC
16	MANDANDA Steve	28.03.85	OLYMPIQUE DE MARSEILLE
MBROJTËS			
19	DIGNE Lucas	20.07.93	EVERTON FC
21	DUBOIS Léo	14.09.94	OLYMPIQUE LYONNAIS
3	KIMPEMBE Presnel	13.08.95	PARIS SG
5	LENGLET Clément	17.06.95	FC BARCELONE
22	MENDY Benjamin	17.07.94	MANCHESTER CITY
2	PAVARD Benjamin	28.03.96	BAYERN DE MUNICH
4	VARANE Raphaël	25.04.93	REAL MADRID CF
15	ZOUMA Kurt	27.10.94	CHELSEA FC
MESFUSHOR			
14	GUENDOUZI Mattéo	14.04.99	ARSENAL FC
13	KANTE N'Golo	29.03.91	CHELSEA FC
6	NDOMBELE Tanguy	28.12.96	TOTTENHAM HOTSPUR FC
17	SISSOKO Moussa	16.08.89	TOTTENHAM HOTSPUR FC
12	TOLISSO Corentin	03.08.94	BAYERN DE MUNICH
SULMUES			
20	BEN YEDDER Wissam	12.08.90	AS MONACO
11	COMAN Kingsley	13.06.96	BAYERN DE MUNICH
18	FEKIR Nabil	08.07.93	REAL BETIS
9	GIROUD Olivier	30.09.86	CHELSEA FC
7	GRIEZMANN Antoine	21.03.91	FC BARCELONE
8	LEMAR Thomas	12.11.95	ATLETICO MADRID
10	MBAPPE Kylian	20.12.98	PARIS SG



PICCOLI CAPRICCI

amma[®]

C A P S U L E

Rezervoni pushimet në 1 nga 10 resortet më të mira në botë
ekskluzivisht me Globus Travel



GLOBUSTRAVEL
Say Globus Think Travel





PËRBALLJET



SHQIPËRI-FRANCË

UEFA EUROPEAN
CHAMPIONSHIP

17 NËNTOR 1990

Shqipëri 0-1 Francë, stadiumi
"Qemal Stafa" (Basile Boli '23)

30 MARS 1991

Francë 5-0 Shqipëri, stadiumi "Parc
De Prince, Paris" (Frank Sauzee '1, '19;
Jean-Pierre Papin '34 (p), '42, Lekbello '79

2 SHTATOR 2011

Shqipëri 1-2 Francë, stadiumi
"Qemal Stafa" (Erjon Bogdani '46/
Karim Benzema '11, Yann M'Vila '18)

7 TETOR 2011

Francë 3-0 Shqipëri, stadiumi "Stade de
France" (Florent Malouda'11, Loïc Rémy
'38, Anthony Reveillere'67)

MIQËSORE

14 NËNTOR 2014

Francë-Shqipëri, stadiumi "Roazhon
Park, Rennes" (Antoine Griezmann'73/
Mërgim Mavraj '40)

13 QERSHOR 2015

Shqipëri-Francë, stadiumi "Elbasan
Arena, Elbasan" (Ergys Kaçe '43)

UEFA EURO 2016

15 QERSHOR 2016

Francë 2-0 Shqipëri, stadiumi
"Stade Velodrome, Marseille" (Antoine
Griezmann '90, Dimitri Payet '95)

UEFA EUROPEAN
CHAMPIONSHIP

7 SHTATOR 2019

Francë 4-1 Shqipëri, stadiumi "Stade
de France, Paris" (Kingsley Coman '8,
'68, Olivier Giroud '27, Jonathan Ikone
'85/ Sokol Cikalleshi '90 (P)



TIRANA

TIRANA, A CITY WITH NEVER-ENDING MOVEMENT AND ENERGY

Tirana is undoubtedly one of the liveliest and most transforming cities in Southeast Europe. It offers numerous opportunities for visitors in every season with its Mediterranean climate. A city that seemingly never sleeps, full of friendly faces and featuring surprises hidden around every corner; this is the feeling that you have walking around Tirana. Culture, adventure and active nightlife are the subject of the Albanian metropolis.

TIRANA ATTRACTIONS

Tirana is a city full of colors, attractions, churches, galleries, mosques and museums. You can start your journey from Scanderbeg's Square, in the center of the capital. Walking around this city square, you can see the Palace of Culture, the Scanderbeg's Monument, the Bank of Albania, the National Historical Museum and the symbol of the city the Clock Tower where you can enjoy a fantastic view of the city. The Clock Tower was built in 1822 by Haxhi Et'hem Beut, the same person who built the mosque next to it.

Attractions for touristic interest in the city of Tirana have tremendously grown in the past few years. Different

museums in Tirana that are also attractions for touristic interest, show the past history like the National Historical Museum, The National Archaeological Museum, Bunk'Art 1 and 2, House of Leaves, Museum of the Bank of Albania, The Bektashi Museum, The Historical Museum of Armed Forces, etc. Also House Studio Kadare, the local museum, which offers different activities for youth people and students related with literature and our famous writer Kadare.

The renovation of the New Bazaar in Tirana adds an attraction for all tourists who visit the capital city. This bazaar was built in 1931 and only grew in size and popularity. Today, it continues to be one of the biggest markets for meat, fish, fruits and vegetables and also near this bazaar you can find traditional restaurants.



NIGHTLIFE IN TIRANA

TIRANA HAS A LOT TO OFFER, THE CHOICE IS YOURS!

One of the most favorite areas is the New Bazaar located near the city center and has the function of a normal market and also a recreational center where you can try delicious food. You can always find a way to be entertained in Tirana in night club-mails or listening to live music, go to the theater, cinema, opera or ballet. The latest films and theater shows always meet the expectations of the growing demands of art lovers. The most fashionable neighborhood is undoubtedly Blloku, where you will find a great diversity of bars, amongst which you will definitely find something to entertain you. You can simply choose to drink something or dance under the rhythms of modern music. Obviously you will remain satisfied by places and people who like this city are always willing to have fun doing all the activities that are proposed.




KUQ E ZI ME GRANDLAND X-IN E RI!

BËJE TËNDIN TANI DUKE FILLUAR NGA 21.700 EUR



opel-noshi.al





Gjirokastra is a magical town on a hill, otherwise known as the Stone City with houses that look like they've been built on top of each other. The city of southern Albania has a unique architecture and is part of the UNESCO World Heritage Site. The hilltop castle is one of the largest in the Balkans and is thought that it was built in the 12th century. At the entrance to the castle, there is a gallery of cannons and a collection of weapons that date from antiquity to World War I and World War II. The center of the old town begins with "Bazaar's neck"(Qafa e Pazarit) and therefore has its origins within the fortress walls that identified the city of Gjirokastra and today it mainly contains tourist souvenir shops. Gjirokastra is also internationally recognized by the writings of famous author Ismail Kadare, who is also his birthplace. Kadare has described the city and the legends it carries in his books translated into several foreign languages. The most interesting attractions you can visit are the house of Skënduli and Zekate, of Ottoman architecture, the Path of the Fools (Sokaku i të Marrëve), the Cold War Tunnel, Gjirokastra Museum and the Ethnographic Museum which holds interesting art collections. The city unveils its values and precious heritage assets through crafts, traditional cuisine and unique architecture. All this features makes this city one of the most visited places for local and foreign visitors.

GJIROKASTRA



BERAT



In the city of Berat life began in the VI-V century, B.C. and later, in the 3rd century B.C., it became a castle town. Berat was officially declared a museum city in 1961, with monuments and cultural heritage, historical and artistic values masterfully realized from generation to generation. The unique architecture of this city, otherwise known as the "City of a Thousand and One Windows", set Berat as part of a UNESCO-protected world heritage site.

Berat is a city that combines history with art and adventure. Berat Castle of the 5th century is the crown of this ancient city with neighborhoods within the walls of the castle that are still inhabited.

Meanwhile Mangalem neighborhood one of the most visited in Berat creates the idea of a pyramid with two story houses which offer an impressive view.

Located inside a cathedral built in 1797 which stands at the highest point of the Berat Castle, the Onufri Museum is one of the most unique attractions of this city with a collection of icons and paintings where the red color dominates. This museum named "Onufri", after the Albanian painter of the 16th century. For any adventure enthusiast, this city offers many opportunities for hiking, rafting, especially in the Osumi Canyon where visitors are numerous.





ARBITRAT E NDESHJES

ROLE

NAME

NAT.

Referee

Slavko Vinčić



Assistant referee 1

Tomaz Klancnik



Assistant referee 2

Andraž Kovacic



4th official

Nejc Kajtazovic



EQUAL GAME



RESPECT

NE JEMI NJË!

Krenarë që mbështesim
Kombëtaren Shqiptare
të Futbollit



E ardhmja
është emocionuese.

Ready?



vodafone